



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 89, datë 31.05.2019

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË PROSPEKTIT TË FONDIT TË PENSIONIT
VULLNETAR “SIGAL”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 9, pika 2, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe të Rregullores nr. 2, datë 13.01.2011 “Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të prospektit të fondit të pensionit vullnetar “Sigal”.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI